

Met Engineering shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2020

	Shenime	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	3,236,740	1,309,255
Llogari te arketueshme tregtare	5	45,486,526	70,540,702
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura	6	2,507,289	-
Te tjera llogari te arketueshme	6	1,096,703	311,922
Inventari	7	4,168,450	23,834,123
Shpenzime te shtyra	8	-	506,117
Total Aktive Afatshkurtra		56,495,708	96,502,119
Aktivët afatgjatë			
Aktive financiare	9	25,954,800	12,900
Aktive afatgjatë materiale	10	3,307,351	3,455,196
Total aktive afatgjatë		29,262,151	3,468,096
Total Aktive		85,757,859	99,970,215
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari te pagueshme tregtare	11	51,319,132	76,778,378
Llogari te pagueshme ndaj paleve te lidhura	14	280,000	-
Detyrime tatimore	12	1,336,363	1,963,596
Provizione	13	364,470	364,470
Te tjera detyrime	14	604,984	308,628
Total Detyrime afatshkurtra		53,904,949	79,415,072
Detyrime afatgjatë		-	-
Total Detyrime afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve		53,904,949	79,415,072
Kapitali aksionar			
Kapitali i nenshkruar		10,000	10,000
Rezerva ligjore		1,000	1,000
Rezerva te tjera		20,544,143	15,152,082
Fitimi i ushtrimit		11,297,767	5,392,061
Total kapitali aksionar	15	31,852,910	20,555,143
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		85,757,859	99,970,215

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

“Met Engineering“ sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	154,979,131	119,990,505
Ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit ne process	17	(262,102)	(866,978)
Puna e kryer nga njesia ekonomike e kapitalizuar		-	-
Te ardhura te tjera te shfrytëzimit	18	108,692	193,495
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		(118,416,313)	(90,181,671)
1) Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	19	(117,259,265)	(88,967,726)
2) Te tjera shpenzime	20	(1,157,048)	(1,213,945)
		-	-
Shpenzime te personelit	21	(22,292,992)	(21,960,540)
1) Paga dhe shperblime		(18,697,141)	(18,797,448)
2) Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore (paraqitur vecmas nga shpenzimet per pension)		(3,595,851)	(3,163,092)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(753,887)	(827,824)
Shpenzime te tjera te shfrytëzimit	22	(59,603)	(2,878)
Shpenzime financiare		-	-
2) Shpenzime te tjera financiare		-	-
Pjese e fitimit/humbjes nga pjesmarrjet		-	-
Fitimi/humbja para tatimit		13,302,926	6,344,109
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	23	(2,005,159)	(952,048)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(2,005,159)	(952,048)
1) fitimin			
Fitimi/humbja e vitit		11,297,767	5,392,061

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

“Met Engineering“ sh.p.k
 Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
 (Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
 Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 Janar 2018	10,000	1,000	3,567,358	3,960,176	7,538,534
Fitimi / Humbja e vitit				7,624,547	7,624,547
Lëvizjet përmes kapitalit			3,960,176	(3,960,176)	-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2018	10,000	1,000	7,527,534	7,624,547	15,163,081
Fitimi / Humbja e vitit				5,392,062	5,392,062
Lëvizjet përmes kapitalit			7,624,547	(7,624,547)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	10,000	1,000	15,152,081	5,392,062	20,555,143
Fitimi / Humbja e vitit				11,297,767	11,297,767
Lëvizjet përmes kapitalit			5,392,062	(5,392,062)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	10,000	1,000	20,544,143	11,297,767	31,852,910

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga administratori i Met Engineering sh.p.k më 20.02.2020 dhe janë firmosur si më poshtë:


 Z. Gazmend Metohu
 Administrator


 Griselda Metaj
 Hartues i pasqyrave financiare

MET-ENGINEERING
 SH. P. K.
 TIRANE, ALBANIA

“Met Engineering“ sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	11,297,767	5,392,061
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(206,966)	(180,603)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	753,887	827,824
Provizione	-	-
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	(93)
Rënie/(ritje) në drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	22,268,223	(20,777,942)
Rënie/(ritje) në inventarë	19,665,673	8,131,628
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(25,806,479)	6,753,731
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	296,356	(15,556)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	28,268,461	131,050
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Para neto të përdorura për blerjen e aksioneve	(25,941,900)	-
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(606,042)	(492,002)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	10,914
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(26,547,942)	(481,088)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	1,720,519	(350,038)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	1,309,255	1,478,690
<i>Efeki i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	206,966	180,603
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	3,236,740	1,309,255

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

“Met Engineering” sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lekë)

1. Informacion i përgjithshëm

“Met-Engeneering” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 18 Gusht 2015 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” me NIPT L52025007R.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 Lek, i zotëruar 100% nga ortaku i vetëm i Shoqërisë, Z. Gazmend Metohu. Administrator i shoqërisë është Z. Gazmend Metohu.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie ka të bëjë me veprimtarinë në fushën e ndërtimit të përgjithshëm; veprimtari në fushën e projektimit dhe zbatimit; veprimtari në fushën e ujësjellës – kanalizimeve; veprimtari në fushën e prodhimit të veprave të artit, skulptura, piktura, skica, grafitë, mozaikë; veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve të ndërtimit, si dhe të veprave të artit brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. “Unaza e Re”, godinë banimi dhe shërbimi, njësia II 04, Tiranë.

Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria kishte 76 punonjës (2019: 57).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Menaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

“Met Engineering” sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lekë)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5 Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3 Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

2.6 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
EURO/Lekë	123.70	121.77
USD/ Lekë	100.84	108.64

“Met Engineering” sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare ç’regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t’u arkëtuar, detyrimeve për t’u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

“Met Engineering” sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Aktive	2020	2019
	Përqindja	Përqindja
Pajisje zyre dhe informatike	25%	25%
Instrumenta dhe vegla pune	20%	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

“Met Engineering” sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.5 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit, që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare, të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15%, (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet. Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	2,812,998	475,582
Mjete monetare në arkë	423,742	833,673
	<u>3,236,740</u>	<u>1,309,255</u>

“Met Engineering” sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lekë)

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Klientë	45,122,056	70,176,232
Klientë për fonde garanci	364,470	364,470
	<u>45,486,526</u>	<u>70,540,702</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kërkesa tregtare të arkëtueshme nga		
Mag Utilities	2,507,289	-
	-	-
	<u>2,507,289</u>	<u>-</u>

Llogaritë e tjera të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
TVSH e kreditueshme	812,412	-
Detyrime doganore	230,055	8,490
Tatim mbi fitimin	-	251,674
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	54,236	51,758
	<u>1,096,703</u>	<u>311,922</u>

7. Inventarë

Llogaria e inventarëve më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Lëndë e parë dhe materiale	4,131,547	23,535,118
Produkt i gatshëm	36,903	299,005
	<u>4,168,450</u>	<u>23,834,123</u>

8. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Llogaria e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Parapagime	-	506,117
	<u>-</u>	<u>506,117</u>

“Met Engineering” sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lekë)

9. Aktive financiare

Aktivet financiare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Aksione të shoqërisë ZMA	25,954,800	12,900
	<u>25,954,800</u>	<u>12,900</u>

“Met Engineering” sh.p.k
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
 (Vlerat janë në Lekë)

10. Aktive Afatgjata Materiale	Instrumenta dhe veglia pune	Automjetet	Pajisje kompjuterike	Totali
<i>Kosto</i>				
Gjëndja më 31 Dhjetor 2018	3,877,914	1,050,000	308,746	5,236,661
Shtesa	492,002			492,002
Nxjerrje jashtë përdorimit	(21,668)			(21,668)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2019	4,348,248	1,050,000	308,746	5,706,995
Shtesa	584,375	-	21,667	606,041
Nxjerrje jashtë përdorimit				
Gjëndja më 31 Dhjetor 2020	4,932,623	1,050,000	330,413	6,313,036
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>				
Gjëndja më 31 Dhjetor 2018	(909,294)	(394,566)	(130,961)	(1,434,821)
Amortizimi i vitit	(652,291)	(131,087)	(44,446)	(827,824)
Nxjerrje jashtë përdorimit	10,847			10,847
Gjëndja më 31 Dhjetor 2019	(1,550,738)	(525,653)	(175,407)	(2,251,798)
Amortizimi i vitit	(613,155)	(104,869)	(35,863)	(753,887)
Nxjerrje jashtë përdorimit				
Gjëndja më 31 Dhjetor 2020	(2,163,893)	(630,522)	(211,270)	(3,005,685)
<i>Vlera neto kontabël</i>				
Gjëndja më 31 Dhjetor 2019	2,797,510	524,347	133,339	3,455,197
Gjëndja më 31 Dhjetor 2020	2,768,730	419,478	119,143	3,307,351

“Met Engineering” sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lekë)

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Furnitorë vendas	50,584,438	76,066,426
Furnitorë të huaj	711,073	699,979
Furnitorë për fatura të pa mbëritura	23,621	11,973
	<u>51,319,132</u>	<u>76,778,378</u>

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	499,498	410,781
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	19,145	14,052
Tatim në burim	-	-
Tatim fitimi	817,720	-
TVSH për t'u paguar	-	1,538,763
	<u>1,336,363</u>	<u>1,963,596</u>

13. Provizionet afatshkurtra

Provizionet afatshkurtra më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Provizion per garanci punimesh	364,470	364,470
	<u>364,470</u>	<u>364,470</u>

14. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime ndaj personelit	594,088	4,832
Përfitime afatshkurtra nga sigurimet	10,896	10,896
Të tjera detyrime	-	292,900
	<u>604,984</u>	<u>308,628</u>

“Met Engineering” sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lekë)

15. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 10,000 Lek, i cili zotërohet 100% nga ortaku i vetëm i shoqërisë, Z. Gazmend Metohu.

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Numri i pjesëve	1	1
Vlera e kapitalit (në Lek)	<u>10,000</u>	<u>10,000</u>
Kapitali themeltar	<u><u>10,000</u></u>	<u><u>10,000</u></u>

Fitimi i ushtrimit të Shoqërisë për vitin 2020 është në vlerën 11,297,767 Lek (2019: 5,392,061 Lek).

16. Të ardhurat nga shitja

Gjatë operimit shoqëria ka realizuar të ardhura sic detajohen më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga punime e shërbime ndërtimi për të tretë	83,797,772	93,436,732
Të ardhura nga shitja e mallrave e materialeve	34,649,810	7,854,236
Të ardhura nga shitja e produktit të gatshëm	11,079,349	14,064,537
Të ardhura nga dhënie asistence teknike	25,452,200	4,635,000
	<u><u>154,979,131</u></u>	<u><u>119,990,505</u></u>

Më poshtë analizohet rakordimi i të ardhurave të deklaruara në Pasqyrën e Performancës dhe ato të deklaruara në FDP –në e TVSH-së dhe Tatim Fitimit:

Kuadrimi i deklarimeve me Bilancin

Shitje total te deklaruara ne FDP TVSH	154,979,176
Ndryshimi I gjendjes se parapagimeve te mara	
Ndryshimi I gjendjes se garancive te mara	
Shitje te dekalruar ne FDP qe jane te ardhura ne PASH	<u>154,979,176</u>
Shitjet	
Punime ndertimi per te trete	83,797,772
Te ardhura nga shitja e materialeve,mallrave dhe PG	45,729,159
Të ardhura nga dhënie asistence teknike	25,452,200
Te ardhura nga sherbime	
Shitje te dekalruar ne FDP qe jane te ardhura ne PASH	<u>154,979,131</u>
Te ardhurat nga interesat bankare	-
Fitim nga kembimet valutore	344,705
Te ardhura te tjera financiare	
Total te ardhura deklaruar ne FDP e Tatim Fitimit	<u>155,323,836</u>
Deklaruar FDP Tatim fitimi	<u>155,323,836</u>
Diferenca	<u><u>0</u></u>

“Met Engineering” sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lekë)

17. Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme prodhimit në proces

Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme prodhimit në proces më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme	(262,102)	(866,978)
	<u>(262,102)</u>	<u>(866,978)</u>

18. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten të detajuara si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Fitime nga këmbimet valutore	344,705	507,598
Humbje nga këmbimet valutore	(236,013)	(314,196)
Te ardhura nga shitja AAM	-	10,914
Kosto e AAM te shitura	-	(10,821)
	<u>108,692</u>	<u>193,495</u>

19. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Kosto e materialeve dhe lendeve të para	68,307,248	76,864,372
Kosto e mallrave	30,270,908	5,258,755
Punime nga te trete / Nekontraktore	12,096,321	603,304
Mirëmbajtje riparime	249,195	296,679
Shpenzime transporti për shitje/blerje	803,634	413,795
Shpenzime certifikimi	496,706	520,429
Qera	4,934,000	4,934,000
Prime sigurimi	63,186	20,790
Energji elektrike	38,067	55,602
	<u>117,259,265</u>	<u>88,967,726</u>

“Met Engineering” sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lekë)

20. Të tjera shpenzime

Të tjera shpenzime më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Qera zyre	160,452	160,452
Konsulenc Ekonomike -Juridike	150,000	150,000
Taksa te ndryshme	431,650	386,442
Shpenzime telefon, internet	152,007	113,899
Sherbime bankare	83,834	86,534
Shpenzime doganore	73,535	47,969
Shpenzime administrative	96,150	267,449
Shpenzime te ndryshme	9,420	1,200
	1,157,048	1,213,945

21. Shpenzime të personelit

Shpenzime të personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime për paga	18,697,141	18,797,448
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3,595,851	3,163,092
	22,292,992	21,960,540

22. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet të tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Gjoha dhe penalitete	59,603	2,878
	59,603	2,878

23. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Fitimi Para Tatimit	13,302,926	6,344,109
Shpenzimet te pazbritshme	64,803	2,878
Shpenzime pritje percjellje		
Penalitet, gjoha e demshperblime	59,603	2,878
Shpenzime te tjera	5,200	
Fitimi Para Tatimit	13,367,729	6,346,987
Tatimi Mbi Fitimin (15%)	2,005,159	952,048
Fitimi Pas Tatimit	11,297,767	5,392,061

“Met Engineering” sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lekë)

24. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

25. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

mazars

Str. Emin Duraku,
B. "Binjaket" No. 5
Tirana, Albania

Tel: +355 4 2222 889
Tel: +355 4 2278 015
www.mazars.al